

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësve të institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi dhe përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Shtator, 2022

Zhvillohen në Bruksel, takimet shpjeguese për kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

26-27.09.2022: Janë zhvilluar në Bruksel, takimet dy-ditore shpjeguese për institucionet shqiptare, përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e *acquis*, kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore". Ministria e Shtetit njëherazi Kryenegociatorja e Republikës së Shqipërisë, znj. Majlinda Dhuka dhe Zëvendësministria e Drejtësisë, negociatore për kapitullin 23, Znj. Adea Pirdeni, kryesuan delegacionin e Qeverisë së Shqipërisë në takimet e para shpjeguese. Ekipi i përbërë nga drejtues dhe përfaqësues teknikë të institucioneve të Kuvendit të Shqipërisë, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Agjencisë për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile u njohën në ditën e parë të takimeve me shpjegimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e garantimit të shtetit të së drejtës, procesit zgjedhor, funksionimit të organeve përfaqësuese të zgjedhura dhe atyre ekzekutive, si dhe krijimit të një mjedisi mundësues për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse. Takimi vijoi në ditën e dytë me shpjegimet për institucionet e fushës së drejtësisë, politikën antikorrupsion, mbrojtjen e të dhënave personale, mosdiskriminimi, të drejtat e fëmijëve, liria e medias. Pjesëmarrës në to ishin drejtues dhe përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, SPAK, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë, Komisionerit për të Drejtën e Informimit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, etj. Procesi do të vijojë në nëntor me zhvillimin e takimeve bilaterale ku Shqipëria do të raportojë dhe informojë para ekspertëve të Brukselit kuadrin rregullator, zhvillimin institucional e të dhëna të tjera statistikore.



Më shumë informacion mund të gjeni në link: <https://www.facebook.com/drejtesia.gov.al>

Sektorët me risk korrupsioni, lobizmi, ndërgjegjësimi dhe edukimit kundër korrupsionit objektivë specifikë të strategjisë kundër korrupsionit, 2023-2030

Idetë	Problemi	Objektivi	Veprimet	Indikatorët
1
2

Idetë	Problemi	Objektivi	Veprimet	Indikatorët
3
4

Idetë	Problemi	Objektivi	Veprimet	Indikatorët
5
6

1-30.09.2022: Ministria e Drejtësisë vijon procesin e hartimit dhe të plotësimit të draft-paketës së plotë strategjike, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2023 – 2030. Gjatë muajit shtator, është kompozuar pasaporta e treguesve dhe është filluar draftimi i planit të parë veprimit, për vitet 2023-2025. Drafti dokumenti është në proces konsultimi dhe diskutimi teknik me ekspertizën teknike të institucioneve politikëbërës, ligjzbatuese dhe të fushës së komunikimit për të konsoliduar një dokument strategjik dhe planifikimi gjithëpërfshirës që do të materializojë prioritetet e qeverisjes në luftën kundër korrupsionit. Grupi teknik i punës bashkëpunon me ekspertizën teknike të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, dhe ka adresuar në përmbajtje të strategjisë rekomandimet e dhëna vendit në raport-progreset e viteve të fundit. Sektorë me risk dhe tendencë për të pasur korrupsion, forcimi i kuadrin rregullator kundër korrupsionit, vendosja e mekanizmave të lobizmit dhe kontrole të shtuara në autoritetet që ushtrojnë kompetenca administrative janë objektiva specifike, risi në strategjinë e ardhshme. Komunikimi dhe vizibiliteti i shtuar kundër korrupsionit dhe prioritizimi i kapaciteteve kërkimore dhe analitike në kuadër të politikëbërjes kanë një vend të shtuar, gjithashtu në këtë dokument. Në vijim, draft strategjia, do të nënshtrohet një faze të dytë të konsultimit publik, gjatë muajit tetor 2022. Përmes këtij procesi, synojmë të hartojmë një kuadër sa më gjithëpërfshirës, i cili do të pasqyrojë vizionin e qeverisë shqiptare për objektivat 2030 të luftës ndaj korrupsionit në nivel kombëtar.

Draft koncept dokumentin e Strategjisë Antikorrupsion 2023-2030, mund ta gjeni të publikuar në linkun: <https://www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-kunder-korrupsionit/>

Rekuperimi i asetëve kriminale, ndërhyrjet strategjike dhe operacionale të fushës mbledhin në Tiranë ekspertë të rajonit të Ballkanit Perëndimor

13-14.09.2022: Lufta kundër korrupsionit është në bashkërendim të vazhdueshëm edhe në nivel bashkëpunimi rajonal. Me iniciativën e UNODC dhe si një komponent i projektit që po zbatohet në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, "Nga flukset e paligjshme financiare në rikuperimin e asetëve", u zhvillua në Tiranë forumi rajonal, me temë për ngritjen dhe krijimin e e strukturës strategjike dhe institucionale të rikuperimit të asetëve dhe rritjen e kapaciteteve të tyre për ndihmën e ndërsjellë juridike. Përfaqësues të zyrave të Rekuperimit të Aseteve, të zyrave të prokurorive, të policive dhe organeve të specializuara të fushës, nga Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Shqipëria u mbledhën në këtë forum dy-ditor për të prezantuar funksionin dhe kryerjen e rikuperimit të asetëve kriminale, kuadrin strategjik rregullator të vendeve, bashkëpunimin ndërkombëtar të fushës si edhe për krijimin e një udhëzuesi tip, për ndihmën e ndërsjellë juridike. Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bëri bashkë ekspertë të fushës së bashkëpunimit juridiksional ndërkombëtar, prokurorë, ekspertë dhe praktikantë të kapjes dhe administrimit të asetëve kriminale për të ofruar bashkëpunim me projektin e UNODC dhe kolegët e vendeve të tjera. Udhëzuesi i Ndihmës së Ndërsjellë Juridike, është një material përmbledhës që do të ndihmojë prokurorët dhe oficerët e organeve ligjzbatuese në ndjekjen e procedurave dhe bashkëpunimit institucional gjyqësor ndërkombëtar. Udhëzuesi për Shqipërinë dhe ai për Kosovën u finalizuan në ditën e dytë të forumit dhe së shpejti kopia finale e tij do të shpërndahet praktikuesve të fushës së ligjit.



Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër krimit ekonomik dhe financiar dhe rekuperimi i asetëve, bën bashkë Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë dhe Policinë me CARIN dhe EUROPOL



20-22.09.2022: UNODC është aktive dhe ka rritur veprimtarinë në bërjen bashkë të profesionistëve dhe praktikuesve të luftës kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe financiar dhe të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në Split, Kroaci u zhvillua seminari rajonal i 6 vendeve të Ballkanit së bashku me përfaqësuesit e rrjeteve CARIN dhe EUROPOL. Rritja e kapaciteteve të zyrtarëve të policisë që ndjekin dhe mbajnë kontaktet me organet homologe të luftës kundër krimit ekonomik e financiar, të prokurorive që ndjekin dhe zbatojnë instrumentet e luftës kundër krimit, të autoriteteve që ruajnë dhe sigurojnë shkëmbimin e informacionit dhe praktikën gjyqësore ishin fokusi i këtij takimi dy-ditor. Lufta kundër krimit ekonomik dhe financiar është e lidhur ngushtë me kapjen dhe konfiskimin e pasurive dhe të mirave që vijnë nga aktiviteti kriminal, dhe bashkëpunimi me rrjetet CARIN e EUROPOL përbën kërkesë dhe qasje drejt veprimeve të përshtatshme kundërvepruese. Prej dy vitesh tashmë Ministria e Drejtësisë si autoriteti politikëbërës dhe përfaqësues ekzekutiv kundër korrupsionit koordinon bashkëpunimin me UNODC, si dhe ofron pjesëmarrjen e ekspertizës vendase në këto takime. Rekuperimi i asetëve që vijnë nga aktiviteti kriminal kërkon bashkëpunim strategjik dhe mbështetje operacionale me organizmat ndërkombëtare.

Rishikimi dhe zbatimi i UNCAC mbledh bashkë specialistët e politikave të rajonit të Ballkanit Perëndimor

27-29.09.2022: Organizata e Kombeve të Bashkuara vijon zhvillimin e aktiviteteve ndërvepruese me specialistë të politikave antikorrupsion. Specialistë dhe praktikantë të kërkimit dhe hartimit të politikave antikorrupsion nga vendet e Ballkanit Perëndimor u mbledhën në një seminar tre-ditor, në Kumbor, Mali i Zi, mbi Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) dhe Mekanizmin e saj të Rishikimit. Seminari synonte të zhvillonte kapacitetet e pjesëmarrësve në njohjen, zbatimin dhe mekanizmat e rishikimit të UNCAC dhe vendosjen e një dialogu konstruktiv midis shoqërisë civile dhe ekspertëve qeveritarë. Përmes kuadrin teorik dhe ushtrimeve praktike, pjesëmarrësit u pajisën me ekspertizë thelbësore mbi dispozitat e UNCAC që kërkohen për t'iu nënshtruar procesit të rishikimit, si dhe për të adresuar vëzhgimet që dalin nga rishikimet, metodologjinë dhe mjetet e përdorura për rishikimin e vendeve, ndërtimin e kapaciteteve për të riprodhuar sesionet e seminareve në nivel kombëtar/rajonal si dhe sigurimi i një platforme për dialog konstruktiv dhe shkëmbim të përvojave. Seminari përbëhej nga sesione plenare që iu mundësuan pjesëmarrësve të kontribuonin përmes prezantimeve, përfshirjes në diskutime dhe shkëmbime informacioni, duke ndërvepruar në mënyrë që të krijoheshin mundësi konkrete të të mësuarit për gjithë pjesëmarrësit. Ministria e Drejtësisë u përfaqësua në këtë aktivitet nga specialistë të fushës së politikave antikorrupsion.





Zhvillohet seminari p[ri planin e angazhimit t[grupave t[interesuara

29-30.09.2022: Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë organizoi trajnimin për menaxhimin e palëve të interesuara. Seminari trajnim dy-ditor, u konceptua për stafin e politikave antikorruption në ministri dhe për anëtarët e Rrjetit të Pikave të Kontaktit Antikorruption në ministritë e linjës dhe në autoritete publike që janë pjesë e nismave dhe angazhimit të politikave antikorruption. Caktimi, pozicionimi dhe krijimi i një bashkëpunimi efektiv me grupe të interesuara, palë interesi, institucione publike dhe ato jashtë administratës, në nivel ekzekutiv dhe ligjzbatues është një shtyllë mbështetëse e çdo kuadri politikash që programohet të rishikohet apo krijohet nga e para. Palët e interesuara kanë interes dhe ndikim në iniciativa politikash dhe në ligjëbërje. Kjo praktikë e mirë dhe efiçente e aplikuar në vende të tjera dhe me eksperiencë të ngritur në këto procese u ofrua edhe për këtë grup praktikuesish të organeve publike në vend, si një mundësi e mirë për të performuar suksesshëm në formulimin e politikave antikorruption dhe në proceset e zbatimit, gjithashtu. Seminari u fokusua në hartimin e një dokumenti: Plani i angazhimit të grupeve të interesuara, për antikorruptionin, mbështetur tek eksperiencia dhe informacioni që ofron Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, në vend. Ky është angazhimi i parë i Ministrisë së Drejtësisë për këtë qëllim, duke treguar një angazhim të plotësuar në nismat e saj, të politikëbërjes antikorruption.



Zhvillohet n[Tiran[aktiviteti antikorruption: Masterclass – Nga heshtja në veprim”

28.09.2022: U zhvillua në Tiranë aktiviteti publik: “Masterclass – Nga heshtja në veprim (engl. *From silence to action*)!”, në kuadër të projektit rajonal të inicuar dhe zbatuar nga organizata Iniciativa Rajonale Antikorruption (RAI). Lufta kundër korrupsionit kërkon angazhim dhe veprime, dhe sinjalizimi dhe sinjalizuesit, janë një instrument që duhet të promovohen dhe evidentohen në shoqëri. Aktiviteti i zhvilluar në Tiranë në prezencë të të rinjve solli në vëmendje rëndësinë dhe nevojën për të shtuar pjesëmarrjen. Autoritetet përgjegjëse në bashkëpunim me partnerët e huaj evidentuan nevojën e rritjes së komunikimit me publikun dhe median për sinjalizimin, dhe mbrotjen e të drejtave të sinjalizuesve, nëpërmjet sjelljes së shembujve të mirë dhe dobiprurës. Ruajtja dhe shpëtimi i financave publike nga korrupsioni është qëllimi i përbashkët dhe aktivitete dhe ndërgjegjësim për përdorimin e instrumenteve është prioritet i yni. Aktiviteti i zhvilluar në Tiranë, është në kuadër të një cikli takimesh të nisura në Sarajevë dhe me tej u zhvilluan në Shkup. Tirana është një qytet i përfshirë plotësisht në evente dhe angazhime antikorruption rajonale.

